



PROJEKTPROGRAM PËR ZHVILLIMIN E UNIVERSITETIT “FAN S. NOLI” TË KORÇËS

(2020 – 2024)

Prof. Dr. Dhimitri Bello

QËLLIMI YNË

RRITJA E CILËSISË SË SHËRBIMEVE TË OFRUARA

Ky projektplan zhvillimi mbështetet në themel në gjithë bagazhin e dijeve dhe përvojës që kemi grumbulluar ndër vite, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të universitetit dhe hapjen drejt një bote në ndryshim.

Historia gati 50 vjeçare e universitetit tonë ka hedhur rrënjë të thella, të cilat ofrojnë një truall të shëndoshë për zhvillimin e qëndrueshëm të universitetit, duke prodhuar energji pozitive që do të shtyjë përpara kërkimin dhe inovacionin.

Roli kryesor që luajnë studentët është gur themeli i drejtimit universitar. Studentët i dhanë jetë UNIKO në fillesat e tij dhe, si gjithmonë, mbeten edhe sot protagonistët e vërtetë të jetës së universitetit.

Edukimi i të rinjve është kështu qëllimi kryesor që universiteti do të ndjekë me vendosmëri jo thjesht për transferimin e njohurive, por mbi të gjitha për të zhvilluar një vizion që shkon përtej së tashmes për të parashikuar çfarëdo që do të sjellë e nesërmja.

Pra, investimi në edukim, trajnim dhe kërkim shkencor i lidhur me nevojat e shoqërisë shënon objektivin strategjik të zhvillimit të UNIKO, nëse do të duam jo vetëm të transmetojmë dije por, më e rëndësishmja, edhe të zhvillojmë një vizion gjithpërfshirës të së ardhmes.

Cilësia mbetet kryefjala e të gjitha veprimtarive të universitetit në 4 vitet në vazhdim, të bindur për ndikimin e rëndësishëm në shoqëri, si drejtpërdrejt ashtu edhe indirekt në nivelin lokal dhe kombëtar. Unë jam i bindur se suksesi i punës së universitetit, tani më shumë se kurrë, varet nga aftësia për të punuar së bashku në mënyrë që të ndikojnë në politikat publike. Si i tillë, Universiteti i Korçës do të shtrijë bashkëpunimin me aktorë lokalë dhe rajonalë, do të përqëndrohet fuqimisht në programet e ndryshme evropiane të shkëmbimit, do të bashkëveprojë me universitete ndërkombëtare në fushën e mësimdhënies, kërkimit dhe sipërmarrjes duke synuar ndërkombëtarizimin e universitetit dhe promovimin e vlerave themelore që janë thelbësore për kërkimin dhe mësimdhënien.



VIZIONI YNË

UNIKO - vendi i ruajtjes, transmetimit dhe përpunimit të dijeve. Ne synojmë drejt një universiteti me qasje nga studenti, duke njohur meritën dhe duke promovuar të drejtën për arsim të lartë.

Si një institucion publik 50-vjeçar, ne e shohim kërkimin shkencor si një hallkë thelbësore për zhvillimin e ideve, projekteve dhe teknologjive që zgjidhin nevojat e komunitetit dhe përqafin të ardhmen.

Si një vend pune ne synojmë krijimin e një mjedisi të ngrohtë, ku studentët, stafi akademik dhe stafi ndihmësimor dhe administrativ i universitetit takohen dhe bashkëveprojnë.



UNIKO përfshin një komunitet individësh, kufijtë e të cilit shtrihen përtej roleve themelore të atyre që studiojnë, japin mësim ose punojnë. Ne synojmë të zhvillojnë përfshirjen e çdo individi në sistem.

Si një institucion që gjeneron njohuri për interes publik, ne synojmë një universitet të hapur për dialog me palët e interesit, të vetëdijshëm për përgjegjësinë tonë të vazhdueshme ndaj shoqërisë si sot dhe nesër.

Ne synojmë një universitet që promovon **QËNDRUESHMËRINË** si një strategji zhvillimi dhe **CILËSINË** si një strategji integrimi

PROCESI I PLANIFIKIMIT

Ky projektprogram është vazhdim i rrugës së shtruar nga strategjitë e mëherëshme të zhvillimit të UNIKO, ndërkohë që prezanton objektiva të reja startegjike që adresojnë sfidat e zhvillimit të vendosura nga jeta moderne.

Ai është zbatim konkret i Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (2016-2021) për politikat afatmesme dhe afatgjata në veprimtarinë e institucioneve të arsimit të lartë dhe ka marrë parasysh sugjerimet e grupeve të interesuara për zhvillimin e UNIKO. Si gur themeli për sistemin tonë të brendshëm të sigurimit të cilësisë, procesi i planifikimit të këtij planprogrami është kryer në mënyrë rigoroze mbi baza kolektive, duke u nisur nga një analizë e kujdesshme pozicionimi që merr në konsideratë parametrat kryesorë dhe treguesit e përdorur nga agjencitë e ndryshme vendase dhe ndërkombëtare të vlerësimit të cilësisë.



✓ Planifikoj #1

Zhvillim strategjik
Planifikim në nivel njësie bazë
Integrim
Menaxhim sipas objektivave (buxheti)

✓ Veproj #2

Veprimtaritë e ndërmara nga strukturat mësimore/ndihmësimore
Veprimtaritë e ndërmara nga strukturat administrative

✓ Kontrolloj #3

Prezantimet në nivel njësie bazë
Prezantimet në nivel njësie kryesore
Takimet me studentët
Takimet me stafin ndihmësimor dhe administrativ

✓ Përmirësoj #4


Rishikimi i objektivave strategjike
Riplanifikimi i veprimtarive dhe masave

VLERAT

Ne aspirojmë një institucion që udhëhiqet nga një sërë parimesh udhëzuese të cilat frymëzojnë strategjitë e së nesërmes dhe veprimtaritë e së sotmes:

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Magna Charta Universitatum dhe Statuti i Universitetit janë burimet që ushqejnë vlerat themelore të UNIKO.

- 1 Mendim kritik
- 2 Gjithëpërfshirje
- 3 Përgjegjshmëri
- 4 Bashkëpunim



Harta Strategjike

Fushat Strategjike

EDUKIMI	KËRKIMI SHKENCOR	MISIONI I TRETË
<p>A:1 Të promovohet cilësia e programeve të studimit dhe të investohet në fusha të veçanta dhe multidisiplinare në mbështetje të nevojave të shoqërisë.</p>	<p>B:1 Mbështetja e kërkimit shkencor bazë dhe të aplikuar, në mënyrë që të ballafaqohemi me sfidat kryesore në kontekstin kombëtar dhe ndërkombëtar</p>	<p>C: 1 Promovimi i zhvillimit kulturor dhe inovacionit shoqëror dhe ekonomik</p>
<p>A: 2 Nxitja e interesit dhe përmirësimi i dimensionit ndërkombëtar të ofertës sonë akademike.</p>	<p>B: 2 Rritja e investimeve në fusha të veçanta dhe multidisiplinare me prioritet për universitetin tonë, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar</p>	<p>C: 2 Përmirësimi i marrëdhënieve me palët e interesit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.</p>
<p>A: 3 Përmirësimi i shërbimeve të ofruara për studentët dhe mbështetja në mënyrë aktive e politikave për të drejtën e arsimit të lartë</p>	<p>A-B.2. Menaxhimi dhe transparenca financiare</p>	<p>A-B.1. Akreditimi dhe kontrolli i cilësisë</p>

Fushat strategjike multidisiplinare



Bujqësia, Ushqimi dhe Mjedisi



Shëndeti



Ekonomia dhe zhvillimi i qëndrueshëm



Gjithëpërfshirja dhe siguria shoqërore



Inteligjenca artificiale



Artet dhe shkencat humane



Arsimi

Fusha Strategjike - EDUKIMI

Objektivi strategjik	Masat	Treguesit
<p>A:I Të promovohet cilësia e programeve të studimit dhe të investohet në fusha të veçanta dhe multidisiplinare në mbështetje të nevojave të shoqërisë.</p>	<p>A:I.1. Përmirësimi i kompetencave të fituara në modulet dhe kurset përkatëse, për të ndihmuar të diplomuarit të hyjnë në tregun e punës.</p>	<p>T.01 Numri i studentëve që përdorin shërbimet e Qendrës së karrierës</p> <p>T.02 Numri i të punësuarve pas 1/3/5 vjetësh</p>
	<p>A.I.2. Konsolidimi i vijueshmërisë së studimeve duke respektuar procedura të rrepta vlerësimi.</p>	<p>T.03 Të diplomuar me punësim të rregullt (N. i viteve)</p> <p>T.04 Nr. i studentëve që kanë fituar >30 ECTS në përfundim të vitit të parë të studimeve.</p>
	<p>A.I.3. Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies duke përshtatur metoda novatore dhe duke trajnuar staf mësimdhënës.</p>	<p>T.05 Nr. i stafit mësimdhënës të trajnuar</p> <p>T.06 Kontrolli i cilësisë së kualifikimeve të stafit mësimdhënës.</p> <p>T.07 Sondazhi i studentëve mbi cilësinë e mësimdhënies</p>
	<p>A.I.4. Nxitja e sinergjisë midis edukimit dhe kërkimit shkencor në fusha prioritare për UNIKO dhe për tregun e punës</p>	<p>T.08 Raporte për rezultatet e nismave të reja për programe studimi në fusha prioritare</p>
	<p>A.I.5. Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies duke respektuar procedurat e rekrutimit të stafit akademik.</p>	<p>T.09 Transparenca në rekrutimin e stafit mësimdhënës.</p>

Fusha Strategjike - EDUKIMI

Objektivi strategjik	Masat	Treguesit
<p>A:2 Nxitja e interesit dhe përmirësimi i dimensionit ndërkombëtar të ofertës sonë akademike.</p>	<p>A:2.1. Tërheqja e studentëve cilësorë, falë edhe veprimtarive specifike të promovimit dhe orientimit në karrierë</p>	<p>T.01 Numri i studentëve të regjistruar në vitin e parë, në të gjitha programet e studimit.</p> <p>T.02 Numri i studentëve të regjistruar në vitin e parë në ciklin e dytë të studimit në programet e ofruara në UNIKO</p> <p>T.03 Plotësimi i kuotave shtesë</p> <p>T.04 Nr. i bursave për studentë cilësorë</p>
	<p>A.2.2. Rritja e numrit të studentëve që vijnë në kuadër të programeve ndërkombëtare të shkëmbimit.</p>	<p>T.05 Incoming exchange students (studentë të huaj të ardhur në UNIKO)</p>
	<p>A.2.3. Rritja e numrit të studentëve me përvojë arsimore jashtë vendit.</p>	<p>T.06 Nr. i outgoing students (studentë të UNIKO që lëvizin në kuadër të mobiliteteve)</p> <p>T.07 Studentë të cilët kanë përfunduar studimet parauniversitare jashtë vendit.</p>
	<p>A.2.4. Fuqizimi i dimensionit ndërkombëtar të ofertës akademike nëpërmjet hartimit të katalogut të studimeve Erasmus+ dhe angazhimit të stafit me përvojë mësimdhënieje jashtë vendit.</p>	<p>T.08 Hartimi i katalogut të studimeve Erasmus+</p> <p>T.09 Nr. i stafit mësimdhënës me përvojë në universitetet e huaja.</p>

Fusha Strategjike - EDUKIMI

Objektivi strategjik	Masat	Treguesit
<p>A: 3 Përmirësimi i shërbimeve të ofruara për studentët dhe mbështetja në mënyrë aktive e politikave për të drejtën e arsimit të lartë.</p>	<p>A.3.1. Forcimi i shërbimeve që synojnë të sigurojnë kushte të përmirësuara studimi dhe jetese për studentët, pjesërisht përmes partneriteteve me aktorë publikë dhe privatë</p>	<p>T.01 Tregues të sigurimit të cilësisë mbi cilësinë e shërbimeve të ofruara për studentët.</p> <p>T.02 Përqindja e studentëve të kënaqur me infrastrukturën e UNIKO.</p>
	<p>A.3.2. Mbështetja e studentëve në nevojë, nëpërmjet koordinimit të masave me institucionet vendore dhe komunitetin për çështjet e “së drejtës për arsimin e lartë“</p>	<p>T.03 Nr. i studentëve në nevojë të mbështetur nga UNIKO</p>
	<p>A.3.3. Përmirësimi i shërbimeve të ofruara nga Qendra e karrierës</p>	<p>T.04 Nr. i kompanive/organizatave të përfshira në mbështetje të studentëve në nevojë.</p> <p>T.05 Përqindja e të diplomuarve në UNIKO të punësuar në biznese vendase.</p> <p>T.06 Përqindja e studentëve që nuk përfundojnë studimet.</p>
	<p>A.3.4. Përmirësimi i shërbimeve të ofruara nga biblioteka universitare.</p>	<p>T.07 Automatizimi i shërbimeve të ofruara.</p> <p>T.08 Vënia në shfrytëzim nga studentët e fondit të digjitalizuar të arkivës.</p> <p>T.09 Rritja e bashkëpunimit me Bibliotekën kombëtare.</p> <p>T.10 Përditësimi i fondit të bibliotekës me tekste mësimore të pedagogëve të UNIKO dhe jo vetëm.</p>

Fusha Strategjike – KËRKIMI SHKENCOR

Objektivi strategjik	Masat	Treguesit
<p>B:I Mbështetja e kërkimit shkencor bazë dhe të aplikuar, në mënyrë që të ballafaqohemi me sfidat kryesore në kontekstin kombëtar dhe ndërkombëtar.</p>	<p>B:I.1. Krijimi i kushteve për hapjen e programeve të studimit të ciklit të tretë.</p>	<p>T.01 Krijimi i Qendrës Noline.</p> <p>T.02 Krijimi i Qendrës së studimeve ballkanike</p> <p>T.03 Nr. i investimeve të kryera për hapjen e programeve të ciklit të tretë.</p>
	<p>B.I.2. Vlerësimi i meritave shkencore në rekrutimin dhe ngritjen në karrierë</p>	<p>T.04 Nr. i stafit të punësuar për kërkim shkencor</p> <p>T.05 Shpërblimi i stafit akademik të angazhuar në shkrimin e projekteve ndrkombëtare</p>
	<p>B.I.3. Përmirësimi i cilësisë së produkteve kërkimore</p>	<p>T.06 Nr. i botimeve në revista shkencore të rankuara në <i>Journal Citation Reports</i> ose <i>SCOPUS</i>.</p> <p>T.07 Nr. i projekteve fituese.</p> <p>T.08 Nr. i pjesëmarrjeve në konferenca ndërkombëtare të akredituara.</p>
	<p>B.I.4. Përmirësimi i infrastrukturës kërkimore.</p>	<p>T.09 Investimet e kryera në infrastrukturën dhe pajisjet kërkimore.</p> <p>T.I0 Mbështetja e ofruar për stafin akademik në marrjen e titujve dhe gradave shkencore.</p>

Fusha Strategjike – KËRKIMI SHKENCOR

Objektivi strategjik	Masat	Treguesit
<p>B:2 Rritja e investimeve në fusha të veçanta dhe multidisiplinare me prioritet për universitetin tonë, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar</p>	<p>B:2.1. Rritja e aftësisë për të bashkëpunuar dhe për të tërhequr fonde kërkimore nga burime kombëtare dhe ndërkombëtare</p>	<p>T.01 Nr. i financimeve nga projekte kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p>T.02 Nr. i trajnimeve për shkrimin e projekteve</p> <p>T.03 Nr. i bashkëpunimeve që Zyra e marrëdhënieve me jashtë ka lidhur me partnerë ndërkombëtarë.</p>
	<p>B.2.2. Zhvillimi i projekteve të reja që do të tërheqin kapacitete ndërkombëtare, duke rritur kështu trashëgimininë multidisiplinare të UNIKO</p>	<p>T.04 Shkalla dhe cilësia e zbatimit të projekteve aktive.</p> <p>T.05 Nr. i marrëveshjeve të lidhura në kuadër të programit Erasmus + kategoria KAI</p>
	<p>B.2.3. Rritja e transparencës në mobilitete e stafit dhe studentëve.</p>	<p>T.06 Përditësimi i faqes zyrtare të UNIKO me numrin e mobiliteteve.</p>

Fusha Strategjike – MISIONI I TRETË

Objektivi strategjik	Masat	Treguesit
<p>C:I Promovimi i zhvillimit kulturor dhe inovacionit shoqëror dhe ekonomik</p>	<p>C.I.1. Hapja dhe përmirësimi i shërbimeve të ofruara në qendra/t e formimit të vazhduar</p>	<p>T.01 Hapja e qendrave të formimit të vazhduar në tri fakultete</p> <p>T.02 Nr. i të trajnuarve nga këto qendra.</p> <p>T.03 Nr. i moduleve të ofruara në këto qendra.</p>
	<p>C.I.2. Funksionalizimi i shërbimeve të ofruara nga Qendra e inovacionit</p>	<p>T.04 Përfshirja e Qendrës së inovacionit në strukturën organizative të UNIKO</p> <p>T.05 Punësimi i stafit me përvojë në menaxhimin e start-up</p> <p>T.06 Nr. i start – up të mbështetura nga UNIKO</p>
	<p>C.I.3. Promovimi i veprimtarive që rritin zhvillimin e qëndrueshëm social, ekonomik dhe mjedisor dhe rivitalizimi i bashkëpunimit me institucione lokale publike dhe jopublike</p>	<p>T.07 Tregues cilësorë për numrin e veprimtarive në mbështetje të iniciativave sociale, mjedisore dhe zhvillimore.</p>
	<p>C.I.4. Promovimi i veprimtarive kërkimore dhe kulturore të cilat rritin imazhin e UNIKO</p>	<p>T.08 Nr. i veprimtarive promovuese të organizuara nga Sektori i promocionit dhe marrëdhënies me publikun.</p>

Fusha Strategjike – MISIONI I TRETË

Objektivi strategjik	Masat	Treguesit
<p>C: 2 Përmirësimi i marrëdhënieve me palët e interesit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.</p>	<p>C.2.1. Zhvillimi dhe nxjerrja në pah e kompetencave të të diplomuarve dhe stafit akademik me qëllim fuqizimin e bashkëpunimit të universitetit me shoqërinë.</p>	<p>T.01 Tregues cilësorë në lidhje me veprimtaritë e organizuara</p>
	<p>C.2.2. Forcimi i strukturave mbështetëse dhe ndërlidhëse midis aktorëve së prodhimit dhe komunitetit akademik</p>	<p>T.02 Veprimtaritë e organizuara nga këto struktura.</p>
	<p>C.2.3. Hartimi i akteve të brendshme institucionale në mbështetje të bashkëpunimit me kompanitë prodhuese</p>	<p>T.03 Rregullimi i marrëdhënieve me palët e treta në rregulloret e brendshme të universitetit.</p>

Prof. Dr. Dhimitri Bello

Korrik, 2020